



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4714 Pro

Fushë-Arrëz, më 23. 12. 2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, më 23.12.2024, ora 10:00, në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pranë Bashkisë Fushë-Arrëz.

Në mbledhje marrin pjesë:

- Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku**;
 - Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak, **znj.Lezina Ceca**;
 - Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak, **z.Bardhok Qafa** ;
- Këshilltarët: **Afrim Ndoj**; **Besjana Marku**; **Franc Doda**
Lin Prendi; **Nikolin Sadiku**; **Tereze Dema**;
Vjollca Tabakaj **Valentina Lleshaj**; **Zef Cara**;

(12 këshilltarë nga 15 gjithsej)

Gjithashtu në mbledhje marrin pjesë:

*Kryetari i Bashkisë, **z. Hil Curri**;

*Administratori i Njësisë Administrative Blerim, **z.Gjovalin Prendi**;

*Administratori i Njësisë Administrative Fierzë, **z. Ylber Sokoli**;

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak **specialistët e Bashkisë** që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

Vjollca Tabakaj, anëtare e Këshillit Bashkiak, largohet nga mbledhja për arsye të reshjeve të shumta të borës dhe rrezikon të bllokohet kalimi në rrugën e lballes,

Mbledhja kryesohet dhe hapet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku**:

Përsëendetje të gjithëve! Mirë se keni ardhë në mbledhjen e fundit plenare të Këshillit Bashkiak për vitin 2024! Në vijim të Njoftimit të fundit zhvillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak. Verifikojmë pjesëmarrjen e cila plotëson kushtet për zhvillimin e mbledhjes.



Parashtrohet rendi i ditës:

1. Miratimi i Projektvendimit për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Nëntor 2024.
2. Miratimi i Projektvendimit për strukturën dhe nivelin e pagave të punonjësve të Administratës së Bashkisë, Njësive Administrative, Institucionet e varësisë dhe funksionet specifike për vitin 2025.
3. Miratimi i Projektvendimit për Paketën Fiskale 2025.
4. Miratimi i Projektvendimit për Prioritetet në Shërbime dhe Investime për vitin 2025 e në vazhdim.
5. Miratimi i Projektvendimit për planin e aktiviteteve, planin e konsultimeve dhe buxhetin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz për vitin 2025.
6. Miratimi i Projektvendimit për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor Afatmesëm 2025-2027 të bashkisë Fushë-Arrëz.
7. Miratimi i Projektvendimit për miratimin e bursave të nxënësve të Arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2024-2025.
8. Miratimi i Projektvendimit për Planin e Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore Iballë-Mezi, në territorin Administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz.
9. Miratimi i Projektvendimit për Planin e Integritetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën 2025-2027.
10. Rishqyrtimi i vendimeve të kthyera nga Prefektura.
11. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.
12. Të ndryshme.

Sqarim: Pika 9 e rendit të ditës për "Miratimin e Projektvendimit për Planin e Integritetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën 2025-2027" do të përjashtohet nga shqyrtimi në mbledhjen e sotme të Këshillit Bashkiak sepse mungon dokumentacioni i duhur.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **Z.Nikolin Bardhoku**:

Atëherë duke përjashtuar pikën 9 ju ftoj të miratojmë rendin e ditës përmes votimit:

➤ Miratohet rendi i ditës me shumicë votash:

11 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al



nivelo me status dhe pa status të nëpunësit civil, specialist inspektor të ndarë në dy nivele, pagesa për këshilltarët dhe pagesa për kryetarët e fshatrave. Këto të dhëna janë njëjtë me të dhënat e vitit 2024 kur është miratuar niveli i ndryshimit të pagave.

Për funksionet specifike, mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi është VKM Nr. 419 datë 26.06.2024, për këto funksione këshilli vetëm informohet sepse nuk ka shuma variabël për pozicionet, mbasi pozicionet janë të përcaktuara me shuma fikse, dmth nuk ka variablin nga-deri, pra është vetëm për njohje në këtë pikë.

Për Bordin e Ujitjes dhe Kullimit dhe për Gjendjen Civile kemi VKM Nr. 421 datë 26.06.2024.

Për arsimin parauniversitar dhe arsimin parashkollor kemi VKM nr. 425, datë 26.06.2024, lidhja nr.3, ndërsa administrimi i pyjeve, sistemohet me të njëjtin VKM që sistemohen edhe pagat e administratës së bashkisë dhe funksioneve të veta

Kaq për sa i përket strukturës dhe nivelit të pagave për bashkinë Fushë-Arrëz për vitin 2025.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku:**

Nëse nuk kanë diçka për të thënë këshilltarët, ju ftoj të miratojmë me votë Projektvendimin për Strukturën dhe Nivelin e pagave të punonjësve të Administratës së Bashkisë, Njësive Administrative, Institucionet e varësisë dhe Funksionet specifike për vitin 2025.

- Miratohet Projektvendimi për strukturën dhe nivelin e pagave të punonjësve të Administratës së Bashkisë, Njësive Administrative, Institucionet e varësisë dhe Funksionet specifike për vitin 2025 **me.**

11 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Pika numër 3 e rendit të ditës: Miratimi i Projektvendimit për Paketën Fiskale 2025.

Vilson Prenga, Përgjegjës i Zyrës Tatim Taksave:

Përshëndetje të gjithëve!

Lidhur me Paketën Fiskale për vitin 2025: Planifikimi i të ardhurave për vitin 2025 ruan të njëjtin nivel me ato të vitit 2024. Në Paketën Fiskale për vitin 2025 nuk ka ndryshime lidhur me taksat dhe tarifat vendore për familjarët, për kategorinë biznese, të vetmet ndryshime që ka për vitin 2025 janë te taksa për pasurinë e paluajtshme ka gjenerim termash dhe më saktë shtohet një zë, dmth çmimi për m² sipërfaqe ndërtimore për ndërtimet e reja të regjistruara sipas lejes së përdorimit në ASHK, pas hyrjes në fuqi të vendimit do të indeksohet me koeficientin 0.2 herë më i lartë se çmimi i sipërfaqes së apartamenteve të banimit sipas listës së përcaktuar në anekset që i bashkangjiten këtij vendimi, më saktë kjo është pasqyruar në Paketën Fiskale në faqen 15.

Një ndryshim tjetër gjendet te taksa e aplikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, në vitin më parë ka qenë për ndërtesa me qëllime banimi është llogaritur 4-8 % për bashkinë Fushë-

E kemi dikutuar këtë pjesë edhe në komisionin përkatës. Nga Ministria e linjës kemi një shkresë me një listë të shkollave të Fushë-Arrëzit tek të cilat kemi detyrimin ligjor për kryerjen e disa shërbimeve. Na detyron ligji që nëse një shkollë ka qoftë edhe një nxënës të vetëm ne duhet t'ia ofrojmë shërbimin.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, z.Nikolin Bardhoku:

E para këtu kemi të bëjmë me mosrakordim mes institucioneve. Këshilli Bashkiak ka të drejtë të ngrejë komisione të përkohshme për një çështje të caktuar sipas ligjit, kështu që në vazhdimësi Besjana mundesh me propozu në këshill , në kuadër edhe të transparencës. Nuk mundet të ketë një investim në një shkollë që nuk ka nxënës për një vit. Ky rast duhet rishikuar në mbledhjet e radhës.

Franc Doda, anëtar këshilli:

Një pyetje kam, toka ku është menduar të ndërtohet qendra multifunksionale, a ka kaluar në pronësi të bashkisë? Toka është e huaja ndërkohë ju mendoni me ndërtu aty.

Kryetari i Bashkisë, z. Hil Curri:

Franc, ajo tokë ku ka qenë fabrika e fibrës është pronë e bashkisë nuk është e ndonjë pronari të caktuar. Asaj toke i mungon tapia. Ne kemi bërë projektin, në vazhdim do të ndjekim procedurat ligjore.

Dritan Lika, Përgjegjës i Zyrës së Financës:

Si rregull në listën e prioriteteve duhet të futet çdo investim i mundshëm që ka nevojë bashkia Fushë-Arrëz. Nuk do të thotë që këto investime se s'bën t'i mbështesim me buxhet por duhet të përfshihen të gjitha. Nuk i dihet ndoshta një moment mund të dalë një financim nga një donator , pse mos t'a kemi në listën e prioriteteve dhe të mbledhim këshillin në raste të caktuara. Mendoj që këshilltarët mund t'a pasurojnë listën e prioriteteve për investime.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, z.Nikolin Bardhoku:

Të lutem, faza e mbledhjes së rekomandimeve ka përfunduar, ajo ka qenë gjatë periudhës së konsultimeve publike që janë zhvilluar në muajt Tetor-Nëntor në të gjitha Njësitë administrative dhe në qendër ku të gjithë këshilltarët e kanë patur mundësinë të shpalosin rekomandimet e mbledhura nga zonat përkatëse. Kërkesa të tilla në këtë moment janë thjesht gjëra të pamenduara , emocionale apo shpikje e momentit të fundit. Këshilltarët që kanë pretendime duhej të merrnin pjesë në dëgjuesat publike dhe atje të bënin rekomandimet e duhura. Tani është faza e celebrimit të punës 3-mujore të përgatitjes së planit të buxhetit, nuk mund të shtojmë apo të ndryshojmë gjë në moment tani.

Ju ftoj të miratojmë me votë Projektvendimin për Prioritetet në Shërbime dhe Investime për vitin 2025 e në vazhdim:



Si i përket BUXHETI VJETOR 2025, ky është i pasqyruar në faqen e fundit me shifra konkrete dhe tashmë ju e keni dhe në dosjet tuaja. Përveç kësaj çdo projekt gjendet i afishuar në web-in zyrtar të bashkisë Fushë-Arrëz.

Faleminderit!

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku:**

Atëherë nëse nuk ka diskutime, unë ju ftoj të miratojmë me votë projektvendimin për Planin e aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz për vitin 2025:

- Miratohet projektvendimi për Planin e aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz për vitin 2025 **me:**

11 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Pika numër 6 e rendit të ditës: Miratimi i Projektvendimit për Buxhetin e vitit 2025 dhe programin buxhetor Afatmesëm 2025-2027 të bashkisë Fushë-Arrëz.

Dritan Lika, Përgjegjës i Zyrës së Financës:

Prezantim i buxhetit për vitin 2025 si dhe buxhetit Afatmesëm 2025-2027:

Kam kënaqësinë të paraqes sot para Jush draft Buxhetin e Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2025. Buxheti i kësaj periudhe financiare është ndërtuar mbi realizimin e treguesve buxhetorë në vite duke ndjekur hap pas hapi një axhendë të mirëpërcaktuar të të gjithë aktiviteteve të parashikuara për realizimin e këtij procesi. Si një dokument thelbësor, ai rregullon veprimtarinë ekonomike të Bashkisë jo vetëm në raport me institucionet e tjera por, mbi të gjitha me vetë komunitetin.

Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2025 vazhdon të ndërtohet mbi bazën e misionit që ka Bashkia Fushë-Arrëz: Misioni: Fushë-Arrëzi, është një qendër e vogël dhe e ripërtërirë urbane, e përfshirë në realitetin e zhvillimeve rajonale në veri të Shqipërisë, një zonë e ripërtërirë ekonomikisht, që mbështetet në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe potencialeve pyjore dhe në turizmin malor.

Të dhëna mbi Bashkinë Fushë-Arrëz:

Bashkia Fushë-Arrëz shtrihet përgjatë rrugës kombëtare Shkodër-Kukës-Prishtinë dhe gjendet në pjesën verilindore të Shqipërisë.

Bashkia Fushë-Arrëz përbëhet nga katër Njësi Administrative dhe Bashkia Qendër dhe numëron rreth 11 500 banorë ose 3791 familje.

Disa të dhëna mbi buxhetin:

Hartimi i këtij dokumenti mbështet në katër parime kryesore dhe konkretisht:

Së pari: Transparenca dhe gjithpërfshirja

Së dyti: Disiplina fiskale



Miratohet Projektvendimi për Prioritetet në Shërbime dhe Investime për vitin 2025 e në vazhdim me:

11 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Pika numër 5 e rendit të ditës: Miratimi Projektvendimit për planin e aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz për vitin 2025.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku:**

Projektin e radhës do t'a prezantojë Naze Selimaj, Sekretar i Këshillit Bashkiak:

Naze Selimaj, Sekretar i Këshillit Bashkiak: Duke ju përshëndet të gjithëve , ju falenderoj që jeni sot këtu në një nga mbledhjet më të rëndësishme të vitit për Këshillin Bashkiak!

Mbështetur në ligjin 139/2015, dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak", Kryetari i Këshillit Bashkiak, z.Nikolin Bardhoku në bashkëpunim me Përgjegjësin e Financës, z. Dritan Lika ka ndërtuar një projekt për planin e aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz për vitin 2025, i cili paraqitet sot në formën e projektvendimit përpara këshilltarëve:

Bashkëlidhur projektvendimit për planin e aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz për vitin 2025 gjenden:

- Plan i aktiviteteve Këshilli Bashkiak Fushë Arrëz 2025;
- Plan vjetor i konsultimeve 2025;
- Shpenzime për konsultime (detajuar nga plani vjetor i konsultimeve)
- Këshilli Bashkiak Fushë Arrëz BUXHETI VJETOR 2025

Sa i përket Planit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz 2025, në tabelë janë përshkruar aktivitetet e Këshillit Bashkiak për çdo muaj, ku përveç mbledhjeve plenare dhe mbledhjeve të Komisioneve të Përhershme në çdo muaj janë përshkruar aktivitete të tjera si Konsultime me komunitetin për çështje të Draft PBA, ndryshim buxheti, norma e standarte të shërbimeve pubike dhe fukioneve të tjera ligjore;

Konsultime me komunitetin për çështje për që sipas ligjit kanë nevojë për konsultim, norma e standarte të shërbimeve publike dhe fukioneve të tjera ligjore; Strategji e Plane;

Ceremoni dhënie titull nderi, etj

Këshilli do të mbajë dëgjesa publike me qytetaret gjate muajve Shkurt, Prill, Maj, Gusht, Shtator, Tetor dhe Nëntor dhe ky plan dëgjesash mund të ndryshojë në varësi të projektvendimeve të paraqitura nga Bashkia.

Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al

29-7

Arrëz, kjo sipas ligjit të ri ka zbritur 1-3 % për bashkinë Fushë-Arrëz. Këto janë të pasqyruara te Paketa Fiskale në faqen 21.

Kaq përsa i përket Paketës Fiskale 2025, Faleminderit!

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku:**

Nëse nuk kanë diçka për të thënë këshilltarët, ju ftoj të miratojmë me votë Projektvendimin për Paketën Fiskale 2025.

➤ Miratohet Projektvendimi për Paketën Fiskale 2025 me:

11 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Pika numër 4 e rendit të ditës: Miratimi i Projektvendimit për Prioritetet në Shërbime dhe Investime për vitin 2025 e në vazhdim.

Tonin Prenga, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit:

Sa i përket investimeve që po përfundojnë këtë vit, ato janë në masën rreth 90% të parashikimeve. Janë në proces ndërtimi i kopshtit i cili po realizohet me bashkëfinancim nga shteti dhe buxheti i bashkisë tonë. Po ashtu edhe ndërtimi i digës së Iballes i cili është financuar thuhet plotësisht nga Ministria e Mbrojtjes dhe 9.5 milion lekë të vjetra janë financuar nga buxheti i bashkisë. Ndërsa investimet në vlera më të vogla janë realizuar pothuajse 100%.

Sa i përket prioriteteve për investime në vitin 2025 dhe në perspektivë:

Kemi ndërtuar një listë me objektet prioritare për investime të ndara sipas llojit dhe funksionit, ju e keni në dosjet tuaja, ku siç e keni vënë re lista është e ndarë në kapituj:

I-projekte të zhvillimit të territorit; II-rruge+ura auto+ura të varura;

III-ujësjellës; IV-vepra vaditëse; V-shëndetësia; VI-arsimi; VII- mjete motorrike

VIII-pyjet dhe kullotat; IX-shërbimi zjarrfikës dhe shpëtimi.

Në vazhdim është parashikuar ndërtimi i një qendre multifunkionale në truallin e ish fabrikës së fibrës në Fushë-Arrëz (Qendër kulturore, bibliotekë, godinë për shtresat në nevojë, qendër sociale për moshën e tretë, vendqëndrim për mjetet e linjave të ndryshme, vendparkim)

Besjana Marku, anëtare e këshillit bashkiak:

Tek investimet për arsimin shoh që është fut investim për rikonstruksion të shkollës 9-vjeçare Flet e cila është e mbyllur tash një vit dhe nuk është fut shkolla 9-vjeçare Çebik e cila momentalisht është në godinën e Njesisë Administrative.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku:**

A është shkolla e Çebikut te lista e prioriteteve?

Tonin Prenga, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit:



Së treti: Shpërndarja e burimeve dhe përdorimi eficient i tyre

Së katërti: Përgjegjësia dhe përgjegjëshmëria në menaxhimin e burimeve Financiare

Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2025 ka synuar:

1. Mbështetjen financiare të kërkesave të komunitetit;
2. Zgjerimin e biznesit në Bashki, pavarësisht potencialit ekonomik të Bashkisë;
3. Investime të shoqëruar me politika specifike në favor të grupeve të ndryshme;
4. Uljen e papunësisë;
5. Rritjen ekonomike etj.

Të ardhurat e Bashkisë për vitin 2025 do të vijnë nga Taksat dhe Tarifat Vendore

të cilat janë programuar në përputhje me Paketën Fiskale të hartuar:

Nga Transferta e pakushtëzuar: Transferta sektoriale; Të trashëguara; Të ardhurat;

Të ardhurat e trashëguara. Në tabelë paraqiten niveli taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025. Për vitin që vjen taksat dhe tarifave vendore ruajnë të njëjtin nivel prej 28 milion e 500 mijë lekë. Realisht viti që lamë pas mund të themi që ka qënë viti më i mirë historik në realizimin e të ardhurave të bashkisë Fushë-Arrëz.

Duhet theksuar fakti që rrugët rurale vazhdojnë të jenë programi me financimin më të dobët nga qeverisja qendrore. Kemi një rrjet rural rrugësh më shumë nga të gjitha Bashkitë, mjaft të amortizuara dhe financimi për to është në vlera shumë të ulëta.

Edhe financimi për mbrojtjen dhe shërbimin e pyjeve është në vlera shumë të ulëta.

Ndërsa për sa i përket financimit për arsimin parashkollor, për mbrojtjen nga zjarri, ujitjen dhe kullimin janë në shifra të pranueshme për buxhetin e bashkisë Fushë-Arrëz.

Shpenzimet e bashkisë paraqiten me tabelat e mëposhte të shfaqura në monitor.

Në total shuma e investimve është rreth 15.3 milion lekë.

Kjo ishte një panoramë e shkurtër për vitin 2025.

Kryetari i Bashkisë, **z. Hil Curri**:

Përsërendetje z. Kryetar i Këshillit Bashkiak, të nderuar këshilltarë, Administratorë të Njësisë Administrative, po bëj një përmbledhëse të shkurtër rreth buxhetit: Në tatimet ne jemi përpjekur të mbledhim më shumë se sa vjet, kemi mbledh taksat e munguara dhe kemi shtuar taksën e ndikimit në mjedis për 3 fabrikat e mëdha me vlerën 1 milion lekë të vjetra, kemi shtuar taksën e fabrikës së bakrit me 20 %.

Buxheti i ardhur nga qeveria është minimal më i vogël se buxheti i vjetshëm, çka nuk i rrit mundësitë për investime.



Pika numër 1 e rendit të ditës: Miratimi i projektvendimit për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Tetor 2024. Atëherë të referojë zyra dhe komisioni përkatës.

Franc Doda, Kryetar i Komisionit të Ekonomisë Financës Buxhetit, jemi konsultuar me zyrën përkatëse në mbledhjen e Komisionit ku për këtë muaj janë hequr nga skema e përfitimit Liljana Doda (Njësia Administrative Qafë-Mali) dhe Nertila Cake (Njësia Administrative Iballe), ndërkohë janë shtuar Bardhe Nimani (Njësia Administrative Iballe) dhe Albert Prendi (Njësia Administrative Iballe). Jemi dakord me propozimet e sjella.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku:** Duke qenë se ju keni rënë dakord i propozojmë Këshillit të miratojmë projektvendimin për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Nëntor 2024.

Atëherë ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Nëntor 2024 përmes votimit:

- Miratohet Projektvendimi për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Nëntor 2024 **me:**

11 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Pika numër 2 e rendit të ditës: Miratimi i Projektvendimit për strukturën dhe nivelin e pagave të punonjësve të Administratës së Bashkisë, Njësive Administrative, Institucionet e varësisë dhe Funksonet specifike për vitin 2025.

Dritan Lika, Përgjegjës i Zyrës së Financës:

Sa i përket strukturës organizative të bashkisë: Struktura organizative e bashkisë për vitin 2025 përmban një numër prej 310 punonjësish. Ky numër punonjësish organizohet në 12 programe buxhetore. Niveli i pagave për vitin 2025 ruan të njëjtin nivel me vitin paraardhës 2024. Për t'a patur më të qartë panoramën e strukturës për vitin 2025 në vijim keni një tabelë (e shfaqur në monitorin e sallës ku dhe po zhvillohet mbledhja) me të gjitha funksionet dhe me numrin e punonjësve për vitin 2024 dhe 2025. Kjo tabelë është e paraqitur edhe në mënyrë grafike në ekran ku duket më qartë situatë e numrit të punonjësve.

Sa i përket nivelit të pagave për secilin nga strukturat buxhetore, është respektuar kuadri ligjor në fuqi, si për pagat e administratës dhe funksioneve të veta që janë shërbime publike, menaxhimi i mbetjeve, administrimi pyjor etj, është respektuar VKM-ja përkatëse dhe nuk ka pasë asnjë ndryshim me miratimin që është bërë në vitin 2024.

Praktikisht të gjitha funksionet e bashkisë janë të shprehura sipas pikave që po ndiqni në monitor për pagat bruto, për pozicionin për secilin punonjës ose grup punonjësish të bashkisë. Në monitor ju po ndiqni të gjithë zërat duke filluar nga paga e Kryetarit të Bashkisë, Zëvendëskryetar, Administratorët e Njësive administrative, Sekretarit të këshillit, Këshilltar i kryetarit, Sekretar i Kryetarit të Bashkisë, Drejtor drejtorie të ndarë në dy nivele me status dhe pa status të nëpunësit civil, po ashtu edhe përgjegjës sektori dhe kryeinspektorë të ndarë në dy



Pika numër 8 e rendit të ditës: Miratimi i Projektvendimit për Planin e Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore Iballe-Mezi, në territorin Administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz:

Ju lutem Ardmir sqaroni projektin në fjalë:

Drejtori i Administrimit Pyjeve dhe Kullotave, **z. Ardmir Doda:**

Përsëndetje të gjithëve!

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjit nr.57/2020 "Për Pyjet", neni nr.11, pika 2, germa b; VKM-në nr.134 datë 3.3.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 datë 08.06.2016 të këshillit të ministrave "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive"; Manualin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot, datë 30.01.2019", Shkresës së Bashkisë Fushë-Arrëz Nr.1639 prot datë 17.05.2024 "Kërkesë për mbështetje teknike për hartimin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave të Bashkisë Fushë-Arrëz"; Shkresës së Fakultetit të Shkencave Pyjore (UBT) nr.378/1 prot datë 02.09.2024 "Përgjigje ndaj kërkesës së Bashkisë Fushë-Arrëz për mbështetje teknike për hartimin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave"; Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Universitetit Bujqësor të Tiranës (Nr.2534 prot datë 10.09.2024) dhe Bashkisë Fushë-Arrëz (Nr.2868 datë 10.09.2024), ju paraqesim draftin e Planit të Mbarështimit të ekonomisë pyjore "Iballe-Mzi", në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz:

Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi 4- vjeçare për asistencë teknike në fushën e pyjeve dhe bujqësisë me Rektorin e Universitetit Bujqësor të Tiranës. Kjo asistencë ka filluar me hartimin e planit të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave Iballe-Mzi. Kemi relacionin, besoj e keni dhe në dosjet tuaja, ku janë shpjeguar të gjitha detajet teknike që stafi i fakultetit të shkencave pyjore kryesuar nga dekani i fakultetit të pyjeve të cilët kanë ndjekur gjithë procedurën sipas manualit së bashku edhe me stafin e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor dhe kemi draftin e ri të planit menaxhimit të pyjeve dhe kullotave për ekonominë pyjore. Është në vazhden që ky draft të shkojë në Prefekturë dhe të kalojë më pas në Ministrinë përkatëse. Lajm i mirë është që Ministria ka miratuar draftin që kemi dërguar për planin e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave në Kryezi, tashmë është aktiv për 10 vitet e ardhshme, mirëpresim investimet që siç janë të parashikuara qoftë edhe në fushën energjetike për energjinë e rinovueshme. Faleminderit!

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku:**

Të falenderoj shumë, në fakt nuk është hera e parë që ne e kalojmë si Këshill Bashkiak, është shumë i rëndësishëm një projekt i tillë për hapjen e mundësisë së investimeve dhe rritjen e të ardhurave të Bashkisë.

Atëherë kush është dakord për të miratuar Projektvendimin për Planin e Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore Iballe-Mzi, në territorin Administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz?



Miratohet Projektvendimi për Planin e Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore
Iballe-Mezi, në territorin Administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz, me:

11 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku:**

Pika numër 9 e rendit të ditës:

Në fillim të mbledhjes proceduam me miratimin e rendit të ditës pa pikën 9, ku cituam se nuk do të trajtohet në këtë mbledhje. Pika 9 e rendit të ditës që lidhet me Projektvendimin për Planin e Integritetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën 2025-2027 shtyhet për një mbledhje tjetër për arsye se mungon dokumentacioni i duhur.

Pika numër 10 e rendit të ditës: Rishqyrtimi i vendimeve të kthyer nga Prefektura.

Nuk kemi vendime të kthyer nga Prefektura.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku:**

Pika numër 11 e rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj:

Nuk kemi të tilla.

Pika numër 12 e rendit të ditës: Të ndryshme

A ka diçka dikush?

Afrim Ndoj, anëtar Këshillit Bashkiak:

Cila ishte arsyeja e rrëshqitjes së urës në Kryezi?

Përgjigjet Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, **z. Hil Curri:**

Ne e kemi pasë lënë me ba riveshjen me beton të këmbës së urës.

Firma me ingjinerët që kanë bërë ndërtimin kanë marrë përsipër me ndërhy në riveshjen e këmbës së urës.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku:**

Atëherë, të nderuar këshilltarë, faleminderit edhe njëherë për pjesëmarrjen dhe seriozitetin e treguar në miratimin e projektbuxhetit, paketës fiskale dhe projektet e paraqitura në pikat e tjera të rendit të ditës.



Për një rast heqje nga puna para se të vinim në në qeverisjen vendore, përmbartimi ka sjellë një shumë prej 30 milion lekësh të vjetra për t'ia kaluar personit. Shuma tjetër që na ka ardhë për shime të tilla është 270 milion lekë të vjetra, ne kemi bërë rekurs në Gjykatën e shkallës së lartë, e cila do të vendosë se si do të operohet për këtë shumë.

Këto minuse janë shumë të mëdha për buxhetin e bashkisë tonë, prandaj m'ë duhet të jem transparent dhe këshilli bashkiak duhet të jetë në dijeni për gjithçka.

Ne do të përqijemi të gjenerojmë të ardhura të tjera përmes aplikimit të planeve të menaxhimit e të tjera sepse me këtë buxhet mundësitë janë të pakta.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku:**

Atëherë nëse nuk ka diskutime, unë ju ftoj të miratojmë me votë projektvendimin për miratimin e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025:

- Miratohet projektvendimi për Buxhetin Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetin e vitit 2025 me:

11 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku:**

Pika numër 7 e rendit të ditës: Miratimi i Projektvendimit për trajtim me bursë të nxënësve të Arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2024-2025. Këtu janë paraqitur dy projektvendime:

- Miratimi i Projektvendimit për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin shkollor 2024-2025.
- Miratimi i Projektvendimit për miratimin e listës së nxënësve të arsimit parauniversitar që përfitojnë bursë për vitin akademik 2024-2025

Atëherë përfaqësuesi përgjegjës, për projektin e parë, pika a), është gati për të dhënë shpjegime? A ka mbetur ndonjë nxënës pa u trajtuar?

Përfaqësuesi përgjegjës, **z. Elis Miria:**

Po, faleminderit! Atëherë bazuar në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit kemi punuar një periudhë të gjatë kohe për të mbledhur dokumentacionin e duhur për të gjithë aplikuesit që plotësojnë kriteret si në udhëzim. Të dhënat specifike jepen në tabelën përkatëse.

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore"; VKM- së 666, datë 10/10/2019, " Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", shkresës me nr.7228/52 prot, datë 18.11.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit , Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar me subjekt "Planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin mësimor 2024 - 2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë i propozojmë



Këshillit Bashkiak të miratojë projektvendimin për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin shkollor 2024-2025. Faleminderit!

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku**:

Atëherë nëse nuk ka diskutime, unë ju ftoj të miratojmë me votë projektvendimin për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin shkollor 2024-2025:

- Miratohet projektvendimi për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin shkollor 2024-2025 **me:**

11 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku**:

Vazhdojmë me pikën **b)**: Miratimi i Projektvendimit për miratimin e listës së nxënësve të arsimit parauniversitar që përfitojnë bursë për vitin akademik 2024-2025.

Përfaqësuesi përgjegjës, **z. Elis Miria**:

Siq e thamë edhe më parë bazuar në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit kemi punuar një periudhë të gjatë kohe për të mbledhur dokumentacionin e duhur për të gjithë aplikuesit që plotësojnë kriteret si në udhëzim.

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; VKM- së 666, datë 10/10/2019, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", si dhe shkresës nr.7228/52 prot, datë 18.11.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar me subjekt 'Plani i numrit të bursave për nxënësit, që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar për vitin mësimor 2024 - 2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë listën e nxënësve të arsimit parauniversitar që përfitojnë bursë për vitin akademik 2024-2025:

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku**:

E rëndësishme është të mos mbetet asnjë që plotëson kriteret e udhëzimit jashtë përfitimit.

Atëherë ju ftoj të miratojmë me votë projektvendimin e pikës **b)** Miratimi i Projektvendimit për miratimin e listës së nxënësve të arsimit parauniversitar që përfitojnë bursë për vitin akademik 2024-2025:

- Miratohet projektvendimi për "miratimin e listës së nxënësve përfitues të arsimit parauniversitar që përfitojnë bursë për vitin shkollor 2024-2025" **me:**

11 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku**:

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Nëse nuk ka ndonjë gjë tjetër dikush nga ju për të thënë, mbledhjen e deklaroj këtu të mbyllur.

Faleminderit të gjithëve për prezencën tuaj! GËZUAR KRISHTLINDJEN DHE VITIN E RI 2025!

Mirë u takofshim ne mbledhjen e radhës!

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

[Signature]

Besiana Marku

[Signature]
Valentina Lleshaq
[Signature]

Nikolin Sadika *[Signature]*
Tereze Dema *[Signature]*
Zef Arre *[Signature]*

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

FRANC JODA

[Signature]

[Signature]
Liridon Prenosi *[Signature]*

Lexina Ceca *[Signature]*

Bardhok Arre *[Signature]*

[Signature]